



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, lidhur me nenin 29, paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017, për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 19.12.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti AKK-DPKI-06-2593/22, për zyrtaren e lartë znj. Eliza Hoxha, Deputete e Parlamentit të Republikës së Kosovës, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

I. Pas identifikimit të rastit lidhur me papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka hapur rastin me numër protokolli AKK-DPKI-06-2593/22, për zyrtaren e lartë znj. Eliza Hoxha, Deputete e Parlamentit të Republikës së Kosovës, duke zhvilluar procedurën e paraparë sipas Ligjit nr.06/L-01 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka filluar trajtimin e rastit në fjalë, duke bërë fillimisht verifikimin dhe konfirmimin e këtij informacioni në institucionet përkatëse prej nga rezultonte se znj. Eliza Hoxha, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtare e lartë publike, respektivisht Deputete e Parlamentit të Republikës së Kosovës, njëkohësisht mbante funksionin e Drejtorit dhe/ose Përfaqësueses së Autorizuar në Organizatat jo-qeveritare “Students Creative Center”, “Qendra për Studime Urbane”, si dhe në biznesin privat “Eliza Hoxha” B.I.

Më pas, në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka dërguar shkresën zyrtare DPKI-06-01/1851/22, duke e njoftuar zyrtaren e lartë për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit. E njëjta është sqaruar gjithashtu se gjatë ushtrimit të funksionit publik, në cilësinë e zyrtares së lartë publike, ajo nuk mund që njëkohësisht të mbajë funksion drejtues e as të jetë përfaqësuese e autorizuar në OJQ dhe/ose biznes privat, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 13, paragrafi 1, të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku thuhet se:



“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”,

si dhe nenin 14, paragrafi 1, i cili përcakton se:

“Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitar e dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të tjera të lidhura me to”.

Pas njoftimit të saj dhe diskutimit të fakteve, zyrtarja e lartë është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se do të ndër marr veprime konkrete në mënyrë që të shmangë papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka pranuar njoftimin përmes të cilit dëshmohet se zyrtarja e lartë znj. Eliza Hoxha, ka bërë ndryshimet e kërkuara, përkatësisht shuarjen subjekteve juridike të sipërpërmendura dhe se e njëjta nuk figuron më të jetë Drejtor e as Përfaqësuese e Autorizuar në biznesin individual dhe OJQ-të në fjalë.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtarja e lartë, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtaren e lartë.


Prandaj, në bazë të asaj që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, lidhur me nenin 29, paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Me respekt!

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik,
- Drejtorit të DPKI-së,
- Zyrtarit përgjegjës


Ylli Buleshkaj
Drejtor i Agjencisë
për Parandalimin e Korrupsionit

